

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7003  
E shtunë, 23 shtator 2023  
Çmimi 0.50 €

Përkujtohen Fehmi dhe Xhevë Lladrovci: Ata ishin fillimi i ortekut të UÇK-së

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SHQIPËRIA DËSHMOI NË OKB SE KOSOVA ËSHTË PRIORITET I SAJ NË POLITIKËN E JASHTME

FAQE 4-5

## SHQIPËRIA, ZË I FUQISHËM I KOSOVËS NË OKB

-Presidenti Begaj para kombeve të botës: Kosova meriton njohjen. Njiheni pavarësinë e saj!



Shqipëria vazhdon të jetë zë i fuqishëm i Kosovës në arenën ndërkombëtare. Një gjë të tillë e ka dëshmuar edhe presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, gjatë fjalimit në Asambleshën e

Përgjithshme të OKB-së. Ai ka kërkuar njohjen universale të pavarësisë së Kosovës. "Kosova është ende në pritje të njohjes së pavarësisë së saj nga shumë vende. Shpresoj që këto vende së shpejti

do ta njohin kontributin e Kosovës për një komunitet global më të drejtë, më paqësor dhe do t'i japin Kosovës njohjen që meriton. Njiheni pavarësinë e Kosovës!", ka thënë Begaj

### AKTUALE



MAHMUTI PËRFUNDON DËSHMINË NË HAGË: UÇK-JA NUK KA VRARË CIVILË F. 7

302 USHTARË TË RINJ I SHTOHEN FSK-së F. 6

HEDHJA E GRANATËS NË VERI, SVEÇLA: URDHRI KA ARDHUR NGA VUÇIQI F. 6

MJEKËT NGA TURQIA KRYEJNË 12 OPERACIONE KARDIOKIRURGIJE TË FËMIJËVE NË QKUK F. 6

### EKONOMI



QEVERIA NDAN 30 MILIONË EURO PËR SUBVENCIONIMIN E PAJISJEVE PËR NGROHJE F. 8

AKB-JA: MBI 250 MIJË BASHKATDHEARË ISHIN NË KOSOVË GJATË VERËS, SHPENZUAN 750 MILIONË EURO F. 8

### SPORT



NORA GJAKOVA FITON MEDALJEN E ARTË NË BAKU, DISTRIA KRASNIQI TË ARGJENDTËN F. 10

ESCOBARI, KURTIT: TË LUTEM, MOS HUMB KOHË! AS UNË S'DUA TË HUMBAS MË SHUMË KOHË ME SEKUENCA

FAQE 2



OSMANI: ROLI I SHBA-SË NË DIALOG ËSHTË PËRCAKTUES

FAQE 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 870 | 045 500 870  
044 500 870 | 049 500 870

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)



**INFINITY**  
Digital Agency

Endrit Shaqiri  
+38344685122

Internet Website,  
Marketing...



## Escobari, Kurtit: Të lutem, mos humb kohë! As unë s'dua të humbas më shumë kohë me sekuenca

UASHINGTON, 22 SHTATOR - I dërguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti të mos humbasë kohë në integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Në një intervistë për mediumin serb në ShBA, "Pavlovic Today", Escobari ka thënë se Ukraina mund të anëtarësohet në BE

para shteteve të Ballkanit Perëndimor. I pyetur se "cili është mesazhi juaj për Kurtin", Escobari ka thënë: "Të lutem, mos humb kohë!". Ai ka thënë se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është obligim për Kosovën. "Procesi i zgjerimit të BE-së aktualisht është real dhe ka shumë presion për integrimin e Ukrainës. Prandaj, unë mendoj

se kur zgjerimi të ndodhë, do të doja t'i shihja të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor të ecin përpara. Por nëse nuk ecin, Ukraina, megjithatë, mund të ecë. Prandaj, nuk dua të humbas më shumë kohë në diskutime teknike të sekuençimit sepse, siç kam thënë më parë, Asociacioni është detyrim ligjor dhe obligueshëm. Duhet të ndodhë", ka thënë Escobari.



## Goditet me raketë baza detare e Rosisë në Detin e Zi

KIEV, 22 SHTATOR - Ukraina e ka kryer një sulm të fuqishëm me raketë të premten ndaj shtabit të përgjithshëm të Flotës Detare të Rosisë në Detin e Zi, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes e Rosisë. Video dhe fotografi të publikuara nga vendi i ngjarjes shfaqën shtëllunga të mëdha tymi mbi ndërtesën në Sevastopol, në Krimesë e aneksuar. Guvernatori i vendosur nga Rusia në Sevastopol, Mikhail Razvozhayev, ka thënë se askush nuk është lënduar jashtë ndërtesës që mori flakë dhe nuk dha hollësi për viktima. Zjarrfikësit dhe forca të shumta emergjente janë thirrur për ta shuar zjarrin, që është tregues se zjarri mund të jetë shumë i madh. Ministria ruse ka thënë se një shërbyes i saj është zhdukur pas sulmit. Banorët e Sevastopolit kanë thënë se kanë dëgjuar shpërthime në qiell dhe se kanë parë tymin, sipas medieve ruse. Fotografitë e



publikuara nga kanalet ukrainase në "Telegram" kanë shfaqur re tymi mbi pjesën e përparme të detit. Ministria e Mbrojtjes e Rosisë ka thënë se pesë raketa janë rrëzuar nga sistemet e saj mbrojtëse ajrore

që kishin cak Sevastopolin. Oleg Kryuchkov, zyrtar për administratën e Krimesë, i ka paralajmëruar fillimisht banorët e Sevastopolit se ekzistonte rreziku edhe për një sulm tjetër dhe u ka bërë thirrje të mos largoheshin

nga shtëpitë e tyre dhe mos të shkonin në qendër të qytetit. Më vonë ai ka thënë se nuk ka më rrezik për ndonjë sulm ajror, por e ka përsëritur thirrjen për qytetarët të mos shkonin në pjesën qendrore të qytetit, duke thënë se

rrugët ishin mbyllur. Policia u ka kërkuar banorëve të largoheshin nga qendra e qytetit, sipas agjencisë ruse të lajmeve, "Tass". Ky sulm vjen vetëm një ditë pasi Rusia ka kryer sulme të mëdha me raketa dhe artileri nëpër qytetet e Ukrainës, duke i vrarë pesë persona, në një kohë kur presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, është takuar me presidentin amerikan Joe Biden dhe liderët e Kongresit në Uashington, për të biseduar për një pako ndihma shtesë në vlerë 24 miliardë dollarë. Qyteti i portit, Sevastopol, shërben si bazë kryesore për Flotën Detare të Rosisë. Gadishulli i Krimesë, të cilin Rusia e ka aneksuar nga Ukraina më 2014 në një veprim të cilin shumica e botës e cilësoi si të jashtëligjshëm, ka qenë cak i shpesh të qëkur presidenti rus Vladimir Putin e urdhëroi pushtimin e plotë të Ukrainës 18 muaj më parë.

## Ngrihet aktakuzë ndaj senatorit Menendez dhe gruas së tij për ryshfet



MANHATAN, 22 SHTATOR - Prokurorët federalë kanë njoftuar të premten se kanë ngritur aktakuzë ndaj senatorit amerikan Robert Menendez, një demokrat nga Nju-Xhersi, dhe bashkëshortes së tij, nën dyshimin se kanë pranuar ryshfet në vlerë mijëra dollarë. Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm në Manhattan, ka thënë se Menendez dhe gruaja e tij, Nadine, akuzohen se kanë pranuar shufra ari dhe para të gatshme në këmbim që

Menendezi ta përdorte pushtetin dhe ndikimin si senator për t'i mbrojtur dhe pasuruar tre biznesmenët të Nju-Xhersit. Menendez, kryetar i Komitetit me ndikim të Senatit amerikan për Marrëdhënie me Jashtë, në të kaluarën ishte akuzuar në Nju-Xhersi për pranimin e fluturimeve private, kontributeve për fushatë dhe llojeve të tjera të ryshfetit nga një patron i pasur në këmbim të favoreve zyrtare, por gjykimi i tij më 2017 mbaroi pasi juria nuk arriti verdikt. Ai ka qenë

pjesë e Senatit që nga viti 2006. Menendez dhe Nadine Menendez përballen me nga tri vepra penale secili: konspiracion për të pranuar ryshfet, konspiracion për mashtrim dhe konspiracion për zhvatje. Prokurorët do të kërkojnë që asetet e Menendezit të konfiskohen, përfshirë shtëpinë e tij në Nju-Xhersi, një veturë "Mercedes-Benz" e vitit 2019, rreth 566 mijë dollarë para të gatshme, shufra ari, si dhe para nga një llogari bankare.

## Ukraina do ta nisë prodhimin e armëve në bashkëpunim me ShBA-në

Uashington, 22 shtator - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka njoftuar se Ukraina do ta nisë prodhimin e përbashkët të armëve me ShBA-në. Masa do të lejojë Kievin ta fillojë prodhimin e

sistemeve të mbrojtjes ajrore si pjesë e një marrëveshjeje afatgjatë, raporton "Sky News". Prodhimi i tyre do të krijojë vende pune dhe një bazë të re industriale në Ukrainë. Njoftimi është bërë me dije

në faqen presidenciale kur Zelensky ka përfunduar një vizitë në ShBA. "Ishte një vizitë shumë e rëndësishme në Uashington, rezultate shumë të rëndësishme. Dhe një marrëveshje afatgjatë - ne do të punojmë së bashku

në mënyrë që Ukraina t'i prodhojë armët e nevojshme së bashku me Shtetet e Bashkuara. Bashkëprodhimi në sektorin e mbrojtjes me Shtetet e Bashkuara është një gjë historike", ka thënë Zelensky.





# Përkujtohen Fehmi dhe Xhevë Lladrovci: Ata ishin fillimi i ortekut të UÇK-së

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

DRENAS, 22 SHTATOR - Janë bërë 25 vjet nga rënia heroike e komandantit të UÇK-së, Fehmi Lladrovci dhe e bashkëshortes së tij Xhevë Krasniqi-Lladrovci. Në nderim të jetës dhe kontributit të tyre për liri, ata janë përkujtuar të premtën nga përfaqësues të institucioneve dhe

front, shënon idealet më të larta të popullit shqiptar në Kosovë. Ndërsa kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka sjellë në kujtesë thënien epike të Fehmi Lladrovci. “Më e shtrenjtë është liria se jeta!”. Prandaj, për Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin, betimi ‘derisa vdekja të na ndajë’, nuk ishte as i mjaftueshëm dhe as i saktë. Për të dy, bashkimi në martesë nënkuptonte përjetësinë, sepse



bashkëlufetarët. Për homazhe në Gllanasellë të Drenasit kanë qenë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, etj.

Pas homazhe te vendi ku prehen Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Konjufca ka thënë se ata ishin bërë frymëzim për luftën qëndrore e heroike të UÇK-së. Ai ka theksuar se aktiviteti i Xhevë dhe Fehmi Lladrovci para dhe gjatë luftës për liri ashtu si dhe rënia e tyre në



jetën tashmë ia kishin premtuar atdheut. Jeta i bashkoi për liri – e vdekja në përjetësi. Sot kujtojmë me krenari edhe bashkëlufetarët e pandashëm të tyre, Fatime



Hetemi, Shefqet Zeka, Behxhet e Milazim Karaxha dhe Hamit Lladrovci, në 25-vjetorin e lartësimin të tyre të përjetshëm”, ka thënë Krasniqi.

Kurse kryetari i BDI-së dhe shoku i Fehmi Lladrovci, Ali Ahmeti, ka thënë se Fehmi dhe Xheva ishin fillimi i ortekut të UÇK-së. “Që të gjithë janë fillimi i ortekut të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Që të gjithë janë edhe bashkëlufetarë të bashkëlufetarëve tanë, Hashim Thaçi e Kadri Veseli si dhe të tjerëve që kanë kaluar nëpër ato dyer. Sot me krenari po dhe me kujtime të kohës, mbase edhe me dhimbje i kujtojmë, sepse të gjithë këta e kanë dashur jetën dhe për këtë arsye edhe kanë sakrifikuar për jetën e të gjithë popullit të Kosovës e më gjerë. Lavdi e përjetshme Fehmiut, Xhevës dhe të gjithë bashkëlufetarëve të cilët ne sot i kujtojmë”, ka thënë Ahmeti.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Fehmi dhe Xheva ishin simbol i qëndresës dhe krah i fortë i lëvizjes për liri dhe pavarësi. “Në këtë përvjetor përulemi me nderim para veprës së tyre heroike. Ata do të jenë gjithmonë udhërrëfyesit tanë në rrugën për ndërtimin e shtetit. Lavdi e përjetshme!”, ka thënë Haradinaj pas homazheve në Gllanasellë të Drenasit.

Fehmi dhe Xhevë Lladrovci ishin ndër figurat më emblematike të organizimit dhe luftës për liri në Kosovë të cilët kanë rënë më 22 shtator të vitit 1998 në një betejë të vështirë e të pabarabartë me forcat serbe pas një qëndrese heroike. Bashkë me ta ka rënë edhe studentja Fatime Hetemi dhe shumë dëshmorë të tjerë.

Fehmi Lladrovci ishte komandant i Brigadës 114 të UÇK-së, emrin e të cilit pastaj e ka mbajtur kjo brigadë. Në sheshin e Drenasit janë vendosur shtoret e dëshmorëve Fehmi dhe Xhevë Lladrovci.

## Osmani: Roli i ShBA-së në dialog është përcaktues

NJU-JORK, 22 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është takuar në Nju-Jork me zëvendëskëshilltarin për Siguri Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Jon Finer.

Gjatë takimit me Finerin, Osmani ka thënë se pavarësisht prej zhvillimeve aktuale politike dhe të sigurisë në rajon, Kosova mbetet e përkushtuar për paqe, dialog dhe partneritet. Ajo ka theksuar se Kosova ka nevojë “për më shumë bashkëpunim politik” me ShBA-në. “Heqja e masave të Bashkimit Evropian (BE) ndaj Kosovës do ta mundësojë rifillimin konstruktiv të dialogut, teksa roli i ShBA-së është përcaktues në dialog”, ka thënë Osmani sipas njoftimit të lëshuar nga zyra e saj, ku është bërë me dije se në këtë takim është biseduar edhe për tensionet e fundit në veri të Kosovës.

Osmani ka thënë se Kosova ka ndërmarrë hapa për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës “dhe është e përkushtuar të punojë me aleatët, në veçanti me ShBA-në, për t’i adresuar sfidat e sigurisë”.

Në takimin me zyrtarin amerikan, Osmani ka thënë se Kosova është e përkushtuar për zbatimin e plotë



të kësaj marrëveshjeje.

Tensionet në veri të Kosovës janë rritur në fund të majit, pasi kryetarët e rinj shqiptarë hynë në ndërtesat komunale mes kundërshtimeve të serbëve lokalë, të cilët kanë bojkotuar zgjedhjet lokale të prillit.

BE-ja dhe ShBA-ja kanë kërkuar nga Kosova të ndërmarë masa për shtensionimin e situatës. Për shkak të mospërmbljes së kërkesave ndërkombëtare, bllokun evropian ka vendosur masa ndëshkuese ndaj Kosovës në fillim të korrikut. ShBA-ja, që e mbështet dialogun e ndërmjetësuar nga Brukseli, ka porositur se themelimi i Asociacionit duhet të jetë ndër

hapat e parë që duhet të bëjë Kosova.

**Osmani në OKB: Gratë në Kosovë kanë qenë gjithnjë në ballë të proceseve të paqes dhe sigurisë**

Me ftesë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), presidentja Vjosa Osmani ka marrë pjesë në takimin e nivelit të lartë dedikuar agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (WPS).

Në organizimin e mbajtur në selinë e OKB-së, Osmani, në emër të Republikës së Kosovës, ka



shpalosur të arriturat dhe objektivat e Kosovës për sa i përket zbatimit të Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Presidentja Osmani ka vënë në pah rolin e jashtëzakonshëm që gratë e Kosovës kanë luajtur në procese të paqes dhe sigurisë përgjatë etapave të ndryshme të historisë. Ajo ka potencuar se Kosova tashmë po i udhëheq përpjekjet në rajon për zbatimin e kësaj agjende. Për më tepër, Osmani ka thënë se Kosova është e gatshme të japë kontribut në nivel ndërkombëtar për zbatimin e kësaj agjende, me çrast ka vënë në pah përpjekjet e Kosovës për të ndihmuar gratë në Ukrainë, Afganistan dhe në çdo

vend ku po ndodhin shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.

Më këtë rast, Osmani ka folur edhe për Forumin Global për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, i cili mbahet këtë vit për herë të dytë në Kosovë, si dhe ka paralajmëruar se Kosova do të bëhet së shpejti vendi nikoqir i qendrës rajonale të ekselencës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Ndërsa zyra e sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, ka vënë në dukje arritjet e Kosovës në këtë drejtim dhe punën e presidentes dedikuar kësaj agjende, duke e quajtur Kosovën një ndër shembujt më të mirë të këtij angazhimi.





SHQIPËRIA DËSHMOI NË OKB SE KOSOVA ËSHTË PRIORITET I SAJ NË POLITIKËN E JASHTME

## Shqipëria, zë i fuqishëm i Kosovës në OKB

-Presidenti Begaj para kombeve të botës: Kosova meriton njohjen. Njiheni pavarësinë e saj!

Shqipëria vazhdon të jetë zë i fuqishëm i Kosovës në arenën ndërkombëtare. Një gjë të tillë e ka dëshmuar edhe presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, gjatë fjalimit në Asamblyenë e Përgjithshme të OKB-së. Ai ka kërkuar njohjen universale të pavarësisë së Kosovës. “Kosova është ende në pritje të njohjes së pavarësisë së saj nga shumë vende. Shpresoj që këto vende së shpejti do ta njohin kontributin e Kosovës për një komunitet global më të drejtë, më paqësor dhe do t’i japin Kosovës njohjen që meriton. Njiheni pavarësinë e Kosovës!”, ka thënë Begaj

**EPOKA E RE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë në krye të detyrës sa i përket afirmimit të shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Pas kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, edhe presidenti Bajram Begaj i ka dalë në mbrojtje shtetit të Kosovës. Begaj në fjalimin vjetor në Asamblyenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) ka thënë se Shqipëria është e ndjeshme ndaj integritetit të Kosovës dhe se e mbështet dialogun e vështirë që është duke vazhduar me Serbinë. “Si Shqipëria ashtu edhe Kosova kanë mbrojtur vazhdimisht paqen mbi tensionet dhe konfliktet dhe ne mbetemi të përkushtuar në këtë rrugë. Shpresojmë të njihen kontributet tona dhe të mos

lejojmë që përpjekjet që bëjmë të errësohen nga qasjet negative. Në këtë kontekst, Shqipëria mbështet dialogun e vështirë që po vijon midis Kosovës dhe Serbisë të lehtësuar nga ndërmjetësimi i kujdesshëm i Bashkimit Evropian dhe mbështetja e fortë e Shteteve të Bashkuara”, ka thënë Begaj. Në të njëjtën kohë, Begaj ka thënë se Shqipëria mbetet e ndjeshme ndaj integritetit dhe prosperitetit të Kosovës. “Kosova ia ka arritur të shërojë shumë plagë të thella nga e kaluara tragjike. Të drejtat e serbëve në Kosovë pasqyrojnë normat dhe vlerat evropiane. E njëjta gjë duhet të vlejë edhe për pakicën shqiptare në Luginën e Preshevës në jug të Serbisë. Fatkeqësisht, ne mbetemi ende të shqetësuar për bërjen joaktive të adresave të tyre të banimit dhe mungesën e investimeve të konsiderueshme, si dhe stimujve

ekonomikë në atë rajon. Kosova ka dëshmuar se dhimbja nuk ka nevojë të lindë armiqësi. Ajo duhet të përkthehet në mirëkuptim dhe mbështetje”, ka deklaruar Begaj. Më tutje, Begaj u ka bërë thirrje shteteve mosnjohëse ta njohin pavarësinë e Kosovës. “Gjithsesi Kosova është ende në pritje të njohjes së pavarësisë së saj nga shumë vende. Shpresoj që këto vende së shpejti do ta njohin kontributin e Kosovës për një komunitet global më të drejtë, më paqësor dhe do t’i japin Kosovës njohjen që meriton. Njiheni pavarësinë e Kosovës!”, ka thënë Begaj.

Ndërsa kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, gjatë fjalës së tij si drejtues i seancës speciale të thirrur në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për Ukrainën, ka ndarë edhe disa fjalë për pavarësinë e Republikës së Kosovës në këtë panel. “Rusia dhe të tjerë janë përpjekur ta keqpërdorin realitetin e ndryshuar të Ballkanit Perëndimor, sidomos lindjen e Republikës së Kosovës për t’i justifikuar ëndrrat e tyre neo-imperialiste apo makthet e tyre që kanë eksportuar. Pavarësisht sa përpiqeni, Kosova, pavarësia e saj, është sanksionuar nga Gjykata Ndërkombëtare Penale, kreu 14 i kësaj karte të OKB-së”, ka thënë Rama, duke shtuar se “Gjykata Ndërkombëtare Penale nuk mund

të shërbejë si pretekst për rrëmbim terrioresh apo aneksim të paligjshëm”. Sipas tij, nëse paqja që zgjat në rajonin tonë sot është e prekshme, kjo së pari ka të bëjë me mësimet e nxjerra për ta tejkaluar të shkuarën dhe për të mësuar një të ardhme të bashku përmes bashkëpunimit.

Kurse në një intervistë për “AbcNews”, ai ka thënë se në këtë seancë ka qenë i përgatitur për çfarëdo skenari sa i takon Kosovës. “Kishim punuar në të gjitha rrjedhat e mundshme dhe të imagjinueshme të debatit, duke pasur parasysh edhe sjelljen e rusëve në vijim ku vjen puna në këtë tryezë për çështjen e luftës dhe njëkohësisht ishim përgatitur mjaft mirë edhe për ta përballuar temën e abuzimit me Kosovën, ç’ka ka qenë një lajtmotiv me propagandën ruse edhe në këtë tryezë, por që me zgjuarsi ministri Lavrov e evitoi pasi u bë e qartë që do t’i kushtonte një tjetër kundërreagim që do ta vinte në pozitë të vështirë përsëri Rusinë. Kështu që, ishte e paevitueshme të kishim një debat, por ishim të përgatitur edhe për një debat më kompleks në rast se rusët do të këmbëngulnin në linjën e tyre abuzive dhe rezistencën e tyre absurde ndaj fakteve dhe ndaj të vërtetave të thjeshta”, ka thënë Rama.

Jo vetëm Shqipëria, por edhe

Kroacia ka bërë thirrje në OKB për njohjen universale të Kosovës. Këtë thirrje e ka bërë presidenti kroat Zoran Milanović. “Ne vazhdojmë ta mbrojmë njohjen universale të Republikës së Kosovës dhe të drejtën e saj për ekzistencë si anëtare e barabartë e bashkësisë së kombeve. Është në interesin tonë ta promovojmë stabilitetin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij rajoni, si dhe procesin e integritetit evropian, i cili besojmë se mbetet vendimtar për prosperitetin e ardhshëm të fqinjëve tanë dhe që shpresojmë se do të përshpejtohet në vitet e ardhshme”, ka thënë Milanović.

**Kosova hedh poshtë të pavërtetat e Vuçiqit në fjalimin në OKB**

Ministrja e Punëve të Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, i ka hedhur poshtë të gjitha deklaratat e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në fjalimin para Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), ku ka akuzuar Perëndimin se duke e njohur Kosovën, “kanë shkelur brutalisht Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe Rezolutën 1244”. Vuçiqi e ka ndërlidhur çështjen e Ukrainës me Kosovën. Sipas tij, “ajo që i ndodhi Serbisë më 2008, po i ndodh Ukrainës sot”. E ka



# Me çfarë mund të përballet Kosova nëse Kurti nuk lëshon pe?

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Bllokim të dialogut, presione shtesë dhe sanksione të mundshme për Kosovën parashohin njohësit e rrethanave politike, nëse kryeministri i vendit, Albin Kurti, nuk u bindet kërkesave të bashkësisë ndërkombëtare për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është ndër hapat e parë që i kërkohet të bëjë edhe nga diplomatët amerikanë, edhe nga ata të Bashkimit Evropian. Kurti ka thënë se është i gatshëm të diskutojë për këtë asociacion, por këmbëngul që, fillimisht, duhet të zyrtarizohet njohja de facto e Kosovës nga Serbia.

Ai i ka acaruar raportet me zyrtarë të BE-së, duke i fajësuar ata për njëanshmëri në procesin e bisedimeve të Kosovës me Serbinë. Shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell, që ka ndërmjetësuar procesin e bisedimeve, ka përsëritur këtë javë se Kosova duhet ta formojë Asociacionin "pa parakushte dhe pa vonesë".

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", se themelimi i Asociacionit duhet të jetë ndër hapat e parë të Qeverisë së Kosovës, në të kundërtën "do të ketë pasoja". Edhe i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se ka ardhur koha për "qasje të re" të Qeverisë së Kosovës ndaj dialogut me Serbinë. "REL"-i ka pyetur Qeverinë e Kosovës se si do t'u përgjigjet këtyre thirrjeve dhe sugjerimeve, por deri

në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje.

## Weber: Kurti nuk do t'u bindet thirrjeve të perëndimorëve

Bodo Weber, ekspert për Ballkanin dhe bashkëpunëtor i lartë i Këshillit për Politikën e Demokratizimit në Berlin, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se kritikën që vijnë nga Prishtina për ndërmjetësuesit perëndimorë, "kanë bazë". Sipas tij, është vetë qasja e ndërmjetësuesve të dialogut ajo që "e ka shtyrë Prishtinën t'u thotë 'jo' disa propozimeve të tyre". "Këtu kemi një kombinim të paraqitjes fatkeqe dhe jostrategjike të autoriteteve të Prishtinës, si dhe arsytjen e justifikueshme të pakënaqësisë me kornizën e përgjithshme të negociatave dhe me qasjen e negociatorëve perëndimorë. Kështu që, çdo mënyrë e presionit që është ushtruar ndaj Prishtinës, duke filluar nga vendosja e sanksioneve, vetëm sa i ka hedhur vaj zjarrit", ka thënë Weber.

BE-ja ka ndërmarrë disa masa ndëshkuese ndaj Kosovës - përfshirë pezullim fondesh dhe takimesh të nivelit të lartë - për shkak të tensioneve të larta në veri, të nxituara nga instalimi i kryetarëve shqiptarë në komunat me shumicë serbe.

Weber ka thënë se çdo masë e re ndëshkuese ndaj Kosovës do të kishte efekt joproduktiv.

Ai nuk pret që Kurti të lëshojë pe ndaj kërkesave të partnerëve perëndimorë, të cilët, siç thotë, "nuk



kanë reaguar dhe ushtruar asnjë presion ndaj Beogradit". "Kam frikë se do të shohim vazhdimin e bllokadës dhe vazhdimin e presioneve, të cilat nuk do të sjellin dobi deri në vitin e ardhshëm. Kam frikë se, përfundimisht, në kryeqytetet perëndimore do ta pranojnë se i gjithë ky kapitull aktual i bisedimeve politike apo dialogut politik, si dhe e gjithë kjo qasje që ka nisur me iniciativën gjermano-franceze, nuk ka pasur sukses, por ka dështuar", ka thënë Weber.

## Demhasaj: Garanci të mjaftueshme nga ShBA-ja, por Kurti nuk bindet

Arton Demhasaj, nga organizata joqeveritare "Çohu" në Prishtinë, ka vlerësuar se Qeveria e Kosovës ka komunikim të ashpër me partnerët e saj perëndimorë, sa i përket dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Sipas tij, partnerët ndërkombëtarë të Kosovës nuk mund ta detyrojnë

Kurtin që të ndryshojë qasje, por mund t'i shtojnë masat ndëshkuese. "Nëse kryeministri Kurti vazhdon t'i injorojë sugjerimet e partnerëve ndërkombëtarë - gjë që mund ta bëjë, sepse ata nuk mund të imponojnë diçka me zor - atëherë mund të ketë pasoja më të mëdha, sanksione më të mëdha, të cilat Kosovën mund ta bllokojnë dhe ngufatin në aspektin e jashtëm", ka thënë Demhasaj për "Radion Evropa e Lirë".

Ai ka thënë se Kurti duhet ta ketë parasysh se partneri më i besueshëm i Kosovës, ShBA-ja, e përkrah zhbllokimin e dialogut, duke i dhënë Kosovës garanci të forta se Asociacioni do të ishte në përputhje me Kushtetutën e saj. "Kjo është e mjaftueshme që të bindet kryeministri Kurti. Por, ai nuk bindet. Për sa kohë mund ta tolerojë faktori ndërkombëtar? Mendoj se e ka toleruar mjaft deri tash. Por, fakti që nuk ka mekanizma tjerë që të bëjë diçka, ndoshta do ta tolerojë edhe për një kohë të gjatë, derisa ta përfundojë

mandatin", ka thënë Demhasaj. Të enjten e kaluar, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë zhvilluar një rund të ri bisedimesh në Bruksel, por pa ndonjë sukses. Ata nuk janë pajtuar rreth hapave për zbatimin e marrëveshjes bazë për normalizimin e marrëdhënieve, të arritur në muajin shkurt.

Ndërmjetësuesit evropianë të procesit, diplomatët Josep Borrell dhe Miroslav Lajçak, kanë thënë se ka qenë Kurti ai që nuk e ka pranuar propozimin e tyre për "përbushje të njëkohshme" të detyrimeve që dalin nga kjo marrëveshje.

Kurti ka thënë se "kushtëzimi i Serbisë" për formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe "është shndërruar në qëndrim të emisarëve të BE-së". Ai e ka fajësuar Lajçakun për pozicionin kundër Kosovës dhe ka thënë se Marrëveshja bazë nuk mund të zbatohet me kushtëzime. Sipas Vuçiqit, "është e qartë se Kurti i shmanget formimit të Asociacionit".

Për këtë asociacion, Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje në vitin 2013, por ajo nuk është zbatuar kurrë, nga frika se mund të ndikojë në funksionalitetin e shtetit.

Kurti në disa raste ka thënë se nuk mund ta lejojë themelimin e një asociacioni njëetnik i cili do të kishte kompetenca ekzekutive siç kërkon Beogradi.

Më herët, po këtë vit, qeveria e tij ka dalë me të ashtuquajturin "model kroat" për Asociacionin, por ai nuk ka shkuar përpara.

akuzuar Perëndimin se me njohjen e Kosovës "po i mohojnë parimet që sot i mbrojnë" duke e ndërlikuar me pushtimin rus të Ukrainës dhe përkrahjen e Perëndimit për Ukrainën.

"Si ministere e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës dënojnë ashpër dhe i hedh poshtë në tërësi si të pavërteta dhe tentim për shtrembërim të historisë deklarimet lidhur me Republikën e Kosovës, të bëra nga presidenti i Serbisë në paraqitjen e tij të sotme para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ku ai, mes të tjerash, zanafillën e agresionit rus në Ukrainë e sheh te pavarësia e Kosovës, dhe paturpshëm pretendon se më 2008 Serbisë i ka ndodhur kjo që po i ndodh Ukrainës sot", ka reaguar Gërvalla.

Ajo ka përsëritur faktet se Kosova është shpallur e pavarur më 17 shkurt 2008 si përmbushje e vullnetit të popullit dhe se deklarata e shpalljes së pavarësisë nuk përbën shkelje dhe se këtë e ka vendosur edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. "Me këto shpifje dhe përpjekje për shtrembërim të historisë, presidenti i Serbisë ka keqpërdorur rëndë foltoren e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Nëse ka një ngjashmëri mes agresionit rus në Ukrainë dhe rastit të Kosovës, ajo është vetëm te


fakti se Rusia sot ka marrë në shënjestër Ukrainën dhe ukrainasit ashtu si Serbia më 1999 kishte marrë në shënjestër Kosovën dhe shqiptarët e Kosovës. Kjo edhe është arsyeja pse Republika e Kosovës sot përkrah pa asnjë hezitim Ukrainën në luftën e saj të drejtë kundër agresorit kriminal rus. Kjo njëkohësisht duket qartë se është arsyeja pse Serbia vazhdon të mbështesë Rusinë e Putinin, siç e konfirmoi hapur dhe pa dilemë vetë presidenti i Serbisë në të njëjtin fjalim në OKB", ka thënë Gërvalla.

Ajo ka vazhduar se Vuçiqi me këtë fjalim ka shkelur edhe zotimet që i ka dhënë para Bashkimit Evropian "kur e ka pranuar marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë, të datës 27 shkurt 2027, dhe aneksin zbatues të datës 18 mars 2023, neni 2 i së cilës përcakton qartë se raportet mes Kosovës dhe Serbisë do të ndërtohen bazuar në parimet e Kartës së OKB-së, posaçërisht atyre që ndërlidhen me barazinë sovranë të shteteve, respektimin e ndërsjellë të pavarësisë dhe integritetit territorial".

Gërvalla ka thënë se në bazë të asaj marrëveshjeje, Vuçiqi para OKB-së është dashur të bënte thirrje për anëtarësimin e Kosovës e jo të lansonte të pavërteta. Ajo e ka akuzuar Vuçiqin dhe Serbinë edhe

për shtrembërim të fakteve për akuzat se Kosova po e bllokoi dialogun. "Bllokuese e dialogut është Serbia dhe presidenti i saj, i cili ka refuzuar nënshkrimin e Marrëveshjes. Ndërmjetësuesit ndërkombëtarë u ka thënë se e pranon, ndërsa publikut në Serbi i thotë se nuk e pranon marrëveshjen e plotë. Ndoshta deklarimet e tilla të njeriut që ka qenë bashkëpunëtor i afërt i krimineleve të luftës, Slobodan Millosheviq e Vojislav Sheshel, mbase mund edhe ta befasonjë dikë në Perëndim që vazhdon të besojë se presidenti aktual i Serbisë është një partner i mundshëm demokratik i BE-së dhe NATO-s. Por, kjo nuk është befasi për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj, të cilët e njohin shumë mirë ish-ministrin e propagandës të Millosheviqit, sot sundimtarin e Serbisë dhe aleatin e Putinin në Ballkan. E njohin edhe politiken që ai përfaqëson, e cila, fatkeqësisht, vazhdon ta mbajë peng të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, para së gjithash popullin serb", ka thënë Gërvalla në reagimin e saj.

Në fund të reagimit Gërvalla i ka bërë thirrje bashkësisë ndërkombëtare, posaçërisht BE-së dhe ShBA-së, ta dënojnë gjuhën e Vuçiqit dhe t'ia rikujtojnë obligimet që ka marrë në Bruksel dhe Ohër.





## 302 ushtarë të rinj i shtohen FSK-së

**FERIZAJ, 22 SHTATOR** - Edhe 302 ushtarë të rinj i janë shtuar Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Ushtarët e rinj kanë dhënë betimin për t'i shërbyer vendit në ceremoninë e diplomimit të rekrutëve të FSK-së, gjenerata 01-2023, në Kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, ku më të mirët janë vlerësuar me mirënjohje. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, u ka thënë ushtarëve të rinj se uniforma që mbajnë, para se të jetë simbol i

ushtresë, është identitet dhe trashëgim i brezave të tërë që kanë kontribuar dhe sakrifikuar për lirinë e Kosovës. Ai i ka porositur ushtarët e rinj ta prezantojnë në mënyrën më të mirë shtetin e Kosovës. "Pesha e uniformës që mbani sot veshur është e rëndë, se shumë rënda e të vështira ishin vitet kur Ademi e Hamza, Zahiri e Luani, Agim Ramadani dhe mijëra dëshmorë të tjerë sfidonin vdekjen duke përqafulur luftën për jetë dhe liri.

Formësimi juaj si ushtarakë fillon këtu dhe nuk duhet të përfundojë asnjëherë, siç nuk duhet të përfundojë vullneti dhe gatishmëria juaj për t'i shërbyer atdheut dhe qytetarëve të vendin tonë", ka thënë Maqedonci. Ndërsa komandanti i KDS-së, gjeneralbrigade Jeton Dreshaj, ka thënë se përgatitja dhe edukimi ushtarak i tyre është një linjë vazhdimësie për zhvillimin dhe gatishmërinë e FSK-së.



## Hedhja e granatës në veri, Sveçla: Urdhri ka ardhur nga Vuçiqi

Prishtinë, 22 shtator - Një granatë dorë është raportuar se ka shpërthyer të enjten mbrëma në "Lagjen e Boshnjakëve" në Mitrovicë të Veriut. Lidhur me këtë shpërthim ka reaguar ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. Ai ka thënë se shpërthimi i kësaj granate ka qenë shenjë revolte për arrestimin e tre serbëve, nën dyshime për krime lufte. "Krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë do të ndiqen deri në fund, ndërsa hedhja e granatës ushtarake të dorës nga grupet kriminale nuk mund ta zbrapsë drejtësinë", ka shkruar Sveçla në "Facebook". Ai ka thënë se ky akt ka ndodhur me urdhër të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "Inspirimi, mbështetja dhe urdhri për këtë akt kriminal ka ardhur nga ish-ministri i propagandës në kohën e Millosheviqit, Aleksandër Vuçiq. Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë. Serbia në krye me

Vuçiqin jo vetëm që nuk e pranon këtë fakt, por glorifikon kriminelët e luftës. Dëshmia e qëndrimit të saj të pandryshuar është vetë planifikimi i aktit të hedhjes së granatës. Kosova do të jetë shteti i së drejtës, i qytetarëve të barabartë, ku barazia dhe prosperiteti do të garantohen për të gjithë", ka shkruar Sveçla. Në raportin 24-orësh të Policisë së Kosovës është thënë se shpërthimi i një granate dore është raportuar në orën 22:40 dhe, "përveç dëmeve materiale, nuk raportohet për të lënduar". Tre serbë janë arrestuar më 20 shtator në veri të Kosovës nën dyshime për krime lufte. E ashtuquajtura Zyrë për Kosovën në qeverinë serbe dhe Lista Serbe i kanë cilësuar arrestimet "të motivuara politikisht". Njoftimi për shpërthim në veri vjen në kohën kur në këtë pjesë të Kosovës - të banuar me shumicë serbe - tensionet vazhdojnë të



jenë të larta që nga fundi i majit, pasi serbët lokalë janë duke

kundërshtuar kryetarët e rinj shqiptarë të zgjedhur në prill,

votime që ishin bojkotuar nga partitë dhe qytetarët serbë.

## Mjekët nga Turqia kryejnë 12 operacione kardiokirurgjike të fëmijëve në QKUK



**PRISHTINË, 22 SHTATOR** - Dymbëdhjetë operacione kardiokirurgjike të fëmijëve dhe 26 raste në sallën e katezimit në kuadër të Klinikës së Kardiologjisë në Shërbimin Spitalor dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) janë kryer nga mjekët nga Turqia në bashkëpunim me stafin e mjekëve dhe infermierëve nga klinikat e QKUK-

së. Me këtë rast, drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi, të premtën ka pritur në takim mjekët nga Turqia, të cilët i ka falënderuar për punën e shkëlqyer që kanë bërë dhe po bëjnë për trajtimin e fëmijëve të Kosovës. Ekipi i mjekëve turq është duke qëndruar në Kosovë në bashkëpunim dhe mbështetje të

organizatës "Muntada Aid", kurse koordinimin punës e ka bërë dr. Ramush Bejiqi. Është bërë me dije se edhe në muajin tetor do të vijë një delegacion tjetër i mjekëve dhe ekspertëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) për të operuar fëmijë që kanë probleme me zemër.

## Rama: 325 familje kanë aplikuar për 70 euro subvencionim për t'i regjistruar fëmijët në çerdhe

**PRISHTINË, 22 SHTATOR** - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se 325 familje kanë aplikuar për të përfituruar 70 euro nga subvencionimi për regjistrimin e fëmijëve në institucione parashkollore private. Po ashtu, Rama ka njoftuar se kanë ndarë 100 mijë euro të

cilat, sipas tij, do të jenë ndihmesë për 125 fëmijë për t'u regjistruar në çerdhe. "325 familje kanë aplikuar për të përfituruar 70 euro subvencionim nga kryeqyteti për regjistrimin e fëmijëve në institucione parashkollore private. Kemi ndarë 100 000 euro, që i bie 125 fëmijë do të mund të regjistrohen në

çerdhe falë ndihmës prej 70 euro nga kryeqyteti. Shumë i lumtur që po e realizojmë edhe një premtim tjetër të fushatës", ka shkruar Rama në "Facebook". Më tutje, Rama ka njoftuar se javën e ardhshme do të shqyrtohen aplikimet dhe më pas do të publikohet lista e përfituesve.





# Mahmuti përfundon dëshminë në Hagë: UÇK-ja nuk ka vrarë civilë

Hagë, 22 shtator - Një nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Bardhyl Mahmuti, ka përfunduar dëshminë në Gjykatën Speciale në Hagë në rastin e Pjetër Shalës. Në dëshminë e tij, Mahmuti ai ka thënë se UÇK-ja nuk ka vrarë civilë. Këtë konstatim Mahmuti e ka dhënë duke u përgjigjur në kundërpëtyjet e prokurorit të specializuar, Filippo De Minicis. Mahmuti ka thënë se nga marsi i 1998-s deri në qershor të 1999-s ka mbajtur mbi 30 konferenca në seli të Kombeve të Bashkuara dhe se këtë qëndrim e ka përsëritur gjithmonë. Ky deklaram i tij ka ardhur pas fillimit të pyetjeve lidhur me një intervistë për gazetarë të huaj, e pretenduar se ka ndodhur më 15 prill 1998 në zyrë të gazetës "Zëri i Kosovës" në Zvicër.

Fillimisht Mahmuti ka thënë se kjo datë vë në dyshim vërtetësinë e saj pasi në atë periudhë nga 11-15 prilli ka qenë në Paris. Ai ka thënë se asnjëherë nuk ka bërë asnjë intervistë me gazetarë të huaj në selinë e kësaj gazete. "Pa e ditur përmbajtjen, ju garantoj se asgjë s'ka të vërtetë sa meë përket mua", ka thënë ai.

Kur prokurori De Minicis ka lexuar një pjesë ku thuhet se dëshmitari ka thënë se UÇK-ja ka vrarë vetëm anëtarë të shërbimeve sekrete represive, zyrtarë të veshur me dhe pa uniforma, ai ka thënë se ky ka qenë deklaram i bërë në takimin me Gelbardin.

Mahmuti ka sqaruar se kishte thënë se cak i sulmeve të UÇK-së kishin qenë pjesëtarë të



aparateve represive dhe se UÇK-ja nuk ka pasur cak vrasjen e civilëve, por shkatërrimin e aparateve represive.

Pas këtyre deklarimeve, prokurori ka paraqitur edhe një komunikatë kur përmendet vrasja e Mustafë Kurtit si bashkëpunëtor i pushtetit dhe ka pyetur dëshmitarin se a nuk konsiderohet civil vrasja e një nëpunësi të zyrës postare.

Mahmuti është përgjigjur duke shtruar pyetjen: "Unë e përmbys pyetjen me pyetje. Çfarë garancie keni që s'ka qenë pjesë e strukturave të aparateve represive ky njeri?".

Në vazhdim, dëshmitari Mahmuti ka thënë se nuk ka lexuar aktgjykimet dënuese të

asnjë procesi gjyqësor që bazën e ka në 27 mijë faqet e shërbimit sekret serb, i cili ua ka dorëzuar autoriteteve të UNMIK-ut. Ai ka thënë se nuk ka lexuar mbi provat e Serbisë dhe se nuk lexon procese gjyqësore të sajua.

Paraprakisht, Mahmuti ka thënë se ai ka qenë nënshkruar i njoftimeve nga takimet që ka mbajtur si përfaqësues politik, por ka shtuar se "asnjë komunikatë në emër të UÇK-së nuk e ka nënshkruar Bardhyl Mahmuti".

Më tutje, Mahmuti ka mohuar autorësinë e komunikatës 59 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në të cilën ishte shpallur tradhtar Gani Geci pas vrasjes së Abedin Rexhës.

Mahmuti ka thënë se komunikata ka qenë kërkesë e NATO-s dhe ShbA-së dhe se ai e ka diktuar të njerëz të publikohet nga Kosova, por se nuk është autor i atij dokumenti.

Ndërsa duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të viktimave Simon Laws, dëshmitari Mahmuti ka thënë se në maj të 1998-s kishte qenë në Kukës, por sapo kishte mbërritur në një shtëpi, ishte telefonuar për të shkuar në Tiranë në mënyrë që të vazhdonte për në Zvicër dhe të takohet me diplomatë amerikanë.

Mahmuti kategorikisht ka mohuar të kenë qenë në njohuri të fabrikës së metalit në Kukës, duke thënë se nuk ka qenë

asnjëherë aty. Madje ai ka thënë se nuk e ka ditur se UÇK-ja në prill-qershor 1999 të ketë pasur bazë në Kukës pasi nuk është marrë me çështje që nuk i kanë takuar.

Lidhur me kalimin e kufirit Kosovë - Shqipëri jashtë pikave kufitare, ai ka thënë se nuk di raste konkrete, por se është e ditur se armatimi është kryer përmes atyre rrugëve.

I pyetur nëse është duke thënë se nuk ka viktima në këtë çështje gjyqësore, dëshmitari ka thënë se viktima civile ka, por se çështja qëndron se kush i ka vrarë.

Më tutje, ai ka thënë se për personat në Kukës ka bindjen se janë sajesa të shërbimeve sekrete serbe dhe se po të dyshonte se Pjetër Shala është i përfshirë në ndonjë krim nuk do të vinte të dëshmonte por, sipas tij, ka ardhur të dëshmojë për sajesa të shërbimit sekret serb me dëshmi serbe. Në këto rrethana, dëshmia e këtij dëshmitari ka përfunduar dhe gjykimi ndaj Pjetër Shalës pritet të vazhdojë më 2 tetor 2023.

Pas përfundimit të dëshmisë, Bardhyl Mahmuti ka bërë një deklaratë të shkurtër publike. "Ju njoftoj se çdo gjë që është thënë gjatë seancave publike dhe aty të mbyllura mbeten në suazat e dhomave të specializuara dhe nuk do të shqyrtohen nga ana ime as ne media e as privatist! Veçanërisht i lus gazetarët që më kanë kërkuar intervistë të kenë mirëkuptim! Faleminderit të gjithëve për mbështetjen që më keni shprehur në këtë sprovë të rëndë!", ka thënë Mahmuti.

## IKD-ja: Viktimat e dhunës në familje kanë të drejtë të kompensohen

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin "Kompensimi i viktimave të dhunës në familje". Të gjeturat në këtë raport kanë bërë me dije se në të gjitha rastet ku ka pasur kërkesa për kompensim të viktimave të dhunës në familje, nuk është vendosur në procedurë penale. Gzim Shala, hulumtues ligjor në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), ka thënë se dhuna në familje vazhdon të mbetet dukuri problematike në Kosovë. "Dhuna në familje vazhdon të mbetet një dukuri problematike në Kosovë dhe pa marrë parasysh veprimet e ndryshme të ndërmarra, fatkeqësisht çështja e parandalimit të luftimit të dhunës në familje si dukuri ende nuk ka rënë në binarët e duhur. Një prej masave të rëndësishme që Kosova ka marrë në këtë drejtim është përfshirja e konventës së Stambollit në Kushtetutën e Kosovës", ka thënë ai.

Ndërsa hulumtuesi tjetër ligjor



në IKD, Flamur Kabashi, ka thënë se aktgjykimet e analizuar nga IKD-ja i përkasin periudhës kohore 2020-2022. Sipas tij, në të gjitha rastet ku është kërkuar kompensimi i viktimave, gjykatat

kanë udhëzuar në kontekst civil. "IKD-ja ka analizuar 50 aktgjykime të gjykatave themelore, të nxjerra në vitet 2020-2022. Këto vendime kanë të bëjnë me veprën e dhunës në

familje. Në mesin e 50 aktgjykimeve, IKD-ja ka gjetur se viktimat nuk kanë kërkuar kompensim në 24 raste (48 për qind), ndërsa kanë kërkuar kompensim 20 raste të tjera (40

për qind). Përderisa në 6 raste tjera (12 për qind) aktgjykimet nuk përmendin nëse viktimat kanë kërkuar kompensim ose jo", ka thënë Kabashi.

Më tutje, Kabashi ka thënë se pavarësisht faktit se viktimat kanë paraqitur kërkesë për kompensim të dëmit të shkaktuar nga vepra penale në 24 raste, IKD-ja ka gjetur se në asnjë prej rasteve gjykatat nuk kanë vendosur në procedurë penale.

Në anën tjetër, hulumtuesja e IKD-së, Shqiponjë Gashi, ka thënë se edhe pse Kodi i Procedurës Penale ua ka dhënë mundësinë viktimave, gjykatat në asnjë rast në procedurë penale nuk kanë vendosur mbi propozimin për kërkesën pasurore juridike. Gashi ka thënë se nga llogaritjet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës është gjetur se që një lëndë civile të marrë një epilog duhet të kalojnë përkatësisht 5.5 vjet. Në rastin e viktimave të dhunës në familje kjo periudhë fillon të rrjedhë vetëm pasi të përfundojë procedura penale.



## Guvernatori i BQK-së: Thesari amerikan dhe Rezerva Federale kanë dhënë kontribut të pazëvendësueshëm për Kosovën

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Departamenti Amerikan i Thesarit dhe Rezerva Federale kanë dhënë kontribut të pazëvendësueshëm për vendin tonë, veçanërisht për Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), është shprehur guvernatori i BQK-së, Ahmet

Ismaili, gjatë takimit me drejtuesit e USAID-it në Kosovë. Në njoftimin e BQK-së është thënë se ndihma e këtyre institucioneve, bashkë me Ambasadën e ShBA-së në Kosovë, ka qenë e pakursyer ndaj sektorit financiar në vend. "ShBA-ja përmes

mbështetjes institucionale nga ambasada, Departamenti i Thesarit dhe Rezerva Federale, kanë dhënë kontribut të pazëvendësueshëm për BQK-në si dhe për gjithë sektorin financiar dhe jo vetëm", është thënë në njoftimin e BQK-së.



## Qeveria ndan 30 milionë euro për subvencionimin e pajisjeve për ngrohje



Prishtinë, 22 shtator - Qeveria e Kosovës ka ndarë 30 milionë euro për subvencionimin e pajisjeve eficiente për ngrohje. Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se kjo është shuma më e lartë financiare që qeveria, në bashkëpunim me Bashkimin Evropian (BE), ka ndarë për subvencionimin e pajisjeve për sektorin e banimit. Përmes kësaj skeme ajo ka thënë se synohet jo vetëm të ulët çmimi i faturave, por edhe të rriten gjasat për furnizim të rregullt me energji elektrike. "Sot po lansojmë thirrjen që subvencionon investimet në pajisje ngrohëse eficiente; si pompë termike, kondicionerë ose klimë të tipit inventer me efikasitet të lartë,

kaldaja dhe stufa individuale me biomasë, si druri dhe veleti", ka thënë Rizvanolli në një konferencë për medie. Investimet në këtë masë janë kyçe për ta rritur efikasitetin e energjisë në sektorin e banimit, ka thënë Rizvanolli pasi, sipas saj, një pjesë e madhe e energjisë nga familjet konsumohet për ngrohje. Aplikimi ka nisur nga e premtdja (22 shtator) në platformën online "E-Kosova" dhe do të zgjasë deri më 25 nëntor 2023. Ata të cilët i plotësojnë kriteret do të përfitojnë një subvencion prej 45-përqindësh të kostos së investimit, e kufizuar në shumën prej 5 500 eurosh. Ndërsa pajisjet që blihen para datës së shpalljes së thirrjes, sipas njoftimit, nuk do

të subvencionohen. Një subvencionim për pajisje të tilla ka ndodhur edhe vitin e kaluar. Rizvanolli ka thënë se përfituesit e vitit të kaluar kanë kursyer deri në 40 për qind në faturat e energjisë elektrike. Me qëllim të kursimit të energjisë elektrike dhe rritjes së mirëqenies në shtëpitë individuale, Qeveria e Kosovës muajin e kaluar ka vendosur të subvencionojë rreth dy mijë familje për izolimin e shtëpive të tyre. Kurse më 17 shtator ka përfunduar aplikimi për fazën e parë të subvencionimit për sistemin diellor të ngrohjes të ujit sanitar. Po ashtu, qeveria është duke subvencionuar pajisje elektrike shtëpiake, si enëlarëse, roblarëse dhe frigoriferë.

## 'Vitin e kaluar për kontratat njëburimore u shpenzuan 78 milionë euro'

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Organizata "Demokrasi Plus" ka publikuar raportin rreth përdorimit të kontratave njëburimore në prokurimin publik gjatë viteve 2019-2023. Ardit Dragusha ka thënë se situata është emergjente ngase gjatë këtyre katër viteve janë lidhur një numër i madh i këtyre kontratave njëburimore. Ndonëse ai ka theksuar se kjo situatë është krijuar për shkak të Covid-19 edhe pas tejkalimit të krizës institucionet e kanë vazhduar një praktikë të tillë. Ai ka sqaruar se në vitin 2019 me kontrata njëburimore janë shpenzuar 68 milionë euro, në



vitin 2020, 56 milionë euro dhe më 2021, 51 milionë euro. Ndërkohë në vitin 2022, sipas IKD-së, janë shpenzuar rreth 78

milionë euro. Dragusha ka pohuar se institucionet që kanë lidhur më së shumti kontrata njëburimore gjatë viteve 2019-2023 janë: komuna e Prishtinës, KEK-u, komuna e Gjakovës dhe komuna e Ferizajt. Sipas tij, problem tjetër që ndikon në lidhjen e kontratave njëburimore janë kapacitetet joadekuate të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. "Në Kosovë kontratat në prokurim publik mund të lidhen përmes disa procedurave. Procedura më e ndjeshme është ajo e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, përmes së

cilës lidhen kontratat njëburimore. Në rastet kur përdoret kjo procedurë, institucionet nuk publikojnë njoftimin për kontratë dhe ftojnë operatorët ekonomikë të ofertojnë. Rrjedhimisht, kjo procedurë nuk është e hapur për operatorët e tjerë të interesuar të ofertojnë, pra kufizon konkurrencën e lirë në mes të operatorëve ekonomikë. Përdorimi i kësaj procedure është definuar në nenin 35 të Ligjit për Prokurim Publik, në të cilin janë parashikuar rastet kur mund të përdoret kjo procedurë", ka thënë Dragusha.

## AKB-ja: Mbi 250 mijë bashkatdhetarë ishin në Kosovë gjatë verës, shpenzuan 750 milionë euro

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka mbajtur një konferencë për medie me temën: "Kontributi ekonomik i diasporës kosovare, vera 2023". Në këtë konferencë është paraqitur hulumtimi rreth efektit ekonomik të diasporës për periudhën 15 qershor deri më 15 shtator të këtij viti. Kreu i AKB-së, Agim Shahini,

ka thënë se në këtë periudhë në Kosovë kanë ardhur mbi 250 mijë bashkatdhetarë, të cilët gjatë qëndrimit dyjavor kanë shpenzuar rreth 2 750 euro. Sipas tij, një mijë deri në tre mijë euro kanë shpenzuar 55 për qind të mërgimtarëve. Ndërsa tre mijë deri në pesë mijë euro, sipas Shahinit, kanë shpenzuar 35 për qind e tyre dhe mbi pesë mijë euro kanë

shpenzuar mbi pesë për qind e mërgimtarëve. Shahini ka sqaruar se të gjitha shpenzimet e mërgimtarëve kapin vlerën e 750 milionë eurove. "Mërgata shpenzoi 2 750 euro përafërsisht në Kosovë gjatë qëndrimit në Kosovë. 750 milionë shpenzoi para kesh në Kosovë këtë verë. Ky është infuzioni më i madh dhënë ekonomikë", ka thënë Shahini.





# Debati i përjetshëm midis fesë dhe shkencës: A ka një rrugë të tretë?



Nga Andrea MURATORE

A po e kërcënon shkencën shkencizmi? A po harrohet Galileo, dhe a po përdor establishmentishkencor dogma të vërteta fetare për çështje që janë aktualisht janë të pavërtetueshme, siç është Teoria e Fijeve? Mbi të gjitha se një pjesë e madhe e establishmentit shkencor, merret me promovimin e bazave shkencore të ateizmit, dhe zhvilluar një luftë kundër Zotit, e cila është e denjë për racionalizmin më të vrazhdë të shekujve XVII–XVIII?

Këto çështje e karakterizojnë shumë debatin e sotëm kulturor. Dhe ato bëjnë të mendosh se dogmatizmi shkencëtar është teke fundit, i vetmi moment historik mbi të cilin mund të interpretohet realiteti. David Berlinski i vë në pikëpyetje këto çështje në librin e tij “Iluzioni i Djallit”.

Një traktat i thellë filozofik, në të cilin ai tregon sesi dogmatizmi shkencor është promovuar mbi të gjitha, nëpërmjet propagandës së ateizmit militant. Shpesh kjo është realizuar duke rritur mbështetjen për nihilizmin, teksa mendimi fetar dhe shpirtëror shihet si një armik ontologjik i shkencës.

A thua se feja e shkencizmit do të ishte i vetmi kult i vërtetë në vend të fesë, i përjetuar si një akt besimi dhe përkushtimi. Një hebre laik, dhe haptazi agnostik, Berlinski ka njëpërgatitje shkencore dhe filozofike. Ai është diplomuar në

Universitetin Princeton në SHBA, dhe ka kryer kërkime në Universitetin e Kolumbias.

Më vonë ka dhënë filozofi dhe matematikë në universitete të ndryshme (nga Stanford në Sorbonë të Parisit). Mendimtar kozmopolit dhe dinamik, ai e gjen veten të përfshirë në njëpolemikë të hapur me ata që në botën shkencore e mbrojnë ateizmin, dhe që janë tëangazhuar në luftën kundër idesë së Zotit, si një parakusht për ushtrimin e drejtë të profesioneve, dhe për të fituar një dukshmëri publike përtej aulave universitare.

Polemika e tij është mbi të gjitha me biologun Riçard Doukins, autor i studimeve që përpichen të tregojnë shkencërisht mos-ekzistencën e Zotit. Ajo e Berlinskit nuk është një luftë kundër shkencës. Përkundrazi, është një luftë për shkencën.

Pra për metodën shkencore dhe kërkimin real përtej “hipotezës sipas së cilës, ne nuk jemi gjë tjetër veçse aksidente kozmike”, siç pretendojnë autorë si Doukins, Zhak Monor, StivenUeinberg. Berlinski thotë se mendimtarët e mëdhenj të së kaluarës, nga Kenet Miler, një biolog i rëndësishëm darvinian, tek Frensis Kollins, drejtor i projektit “Gjenomi njerëzor”, e pranuan se si ideja fetare u studiua prej tyre në një formë që nuk ishte vetëm militante.

Ndërkaq Stiven Gullid, një ndër studiuesit më të mëdhenj të evolucionit deklaroi se “shkenca

dhe feja përbëjnë dy magji, që nuk mbivendosen dot mbi njëra-tjetrën”. Për të mos përmendur pozicionin e Albert Ajnshtajnit mbi këtë temë, apo dyshimet e mëdha ontologjike që u shfaqën në vazhden e krijimit të bombës së parë bërthamore.

Ideja që një sistem tjetër mendimi mund të përballet me sistemin e tyre, është për Berlinskin problemi i vërtetë që kanë sot shumë shkencëtarë. “Sulmi ndaj mendimit fetar” dhe tallja e botëkuptimit të tij teleologjik dhe transhendent “shënon konsolidimin aktual të shkencës”

si i vetmi sistem besimi, “në të cilin burrat dhe gratë racionale mund të gjenin besimin e tyre, nëmos besimin, të paktën përkushtimin”. Nga këtu buron tendenca për të zgjidhur problemet (teoria e përgjithshme, fizika kuantike, studimi i trurit të njeriut) tek të cilat ka ende gjëra për t’u zbuluar. Pra për të zbatuar një metodë të shëndoshë shkencore, të shoqëruar me narrativa.

Edhe vetë teoria e Big Bengut përballet me pasiguri në rritje, ndërsa i afrohet momentit zero të ngjarjes, që do të krijonte kohën dhe hapësirën. Ajo përshkruan me një saktësi të madhe evolucionin e Universit nga një pikë e saktë në kohë dhe hapësirë, dhe sot nuk i jep përgjigje përfundimtare pyetjeve mbi kohën dhe hapësirën.

Dhe vetëm duke nxitur dyshimin, apo studimin sistematik, mund të zbulohet misteri dhe tëkuptohet

më shumë. Si një agnostik, Berlinski, na fton të mos tallemi me asnjë hipotezë, madje as atë që qëndron në themelin e të ashtuquajturit “parim antropik” apo idesë së Dizajnit Inteligent.

Ai na fton të ndjekim mësimin e teologut islam El-Gazali, për të cilin është vënë shpesh në pikëpyetje aftësia e “një organi të kufizuar si truri i njeriut për të parë në zemrën e thellë të materies dhe matematikës”. Një opsion edhe më i pamundur, kur i referohemi makinerive dhe algoritmeve që janë në shkallë të ndryshme, një derivat i trurit të njeriut.

Teza bazë e mendimit të Berlinskit, është se duhet të hidhet poshtë çdo narrativëabsolutiste: Si një fe obskurantiste, ashtu edhe një shkencë verbuese, e pengojnë njeriun të shohë me sytë e tij, duke e larguar atë nga kurioziteti, si dhe përdorimi i zgjuarsisë dhe aftësive të tij racionale.

Që të dyja dëshirojnë një kërkim për të vërtetën, e cila kalon përmes supozimit të zotërimit të saj që në fillim. Rëndësia sociale e shkencës në ditët tona, kërkon që ne të hedhim poshtë dogmatizmin e atyre që preferojnë dominimin e paradigmeve dhe narrativave, dhe që e përdorin ateizmin militant si një formë propagande e një feje të re, atë të një shkence monolite dhe aspak të hapur ndaj dyshimeve të komunitetit të saj.

Një shkencë është e tillë, nëse dhe vetëm nëse funksionon sipas një metode induktive-deduktive, e

cila kalon përmes vëzhgimit të dukurive dhe ndërtimit të hipotezave. Ajo nis nga një induksion i domosdoshëm, nëpërmjet vëzhgimeve dhe ndërtimit të formulave, por deduktohet detyrimisht nëpërmjet një eksperimenti.

Kur kjo metodë dështon, krijohet një zhvendosje e rrezikshme fazore, veçanërisht nëse modelimi mbizotëron mbi eksperimentimin real. Por ku është realiteti? Duket sikur ka pasur një divorc me metodën tradicionale të kërkimit. Duket sikur bota ishte një silogizëm, për të parafrazuar Hegelin: gjithçka që është e arsyeshme është reale, dhe gjithçka që është reale është e arsyeshme.

Nuk ka asnjë dyshim se situata është pak më komplekse, dhe ka të bëjë me dëshirën njerëzore për të zbuluar, eksploruar dhe ditur. Fakte që nuk kanë asnjë mospërputhje me vullnetin për të kërkuar ndjenjën e thellë të ekzistencës, dhe të të kuptuarit e rolit të dikujt në krijimin e Universit.

Pikërisht aty ku mund të bashkëjetojnë shkenca dhe feja. Këtë e dinte edhe Galileo, për të cilin në fund të fundit “matematika, është alfabeti me të cilin Zoti shkroi Universin”. Një vizion i thellë dhe dinamik i mohuar shpesh nga ata që me armën e ateizmit militant, duan të zëvendësojnë shkencën me shkencizmin.

| “Il Giornale” – Bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Aksidentohet autobusi i KFF Jakova, lëndohet tetë futbolliste dhe trajneri

**GJAKOVË, 22 SHTATOR** - Automjeti me të cilin po udhëtonin futbollistet dhe stafi i KFF Jakova gjatë kthimit nga një aktivitet nga Shqipëria është rrokullisur mbrëmjen e kaluar në afërsi të Junikut. Si pasojë e këtij aksidenti dy futbolliste dhe trajneri i skuadrës së

senioreve, N. Kamberi, ndodhen aktualisht për trajtim të mëtutjeshëm në spitalin e Gjakovës por, fatmirësisht, janë pa lëndime serioze dhe jashtë rrezikut për jetë. Pjesa tjetër e futbollisteve, pas trajtimit të duhur mjekësor, në mesditë, janë liruar në shtëpi.

Klubi i KF Gjakovës e ka konfirmuar këtë lajm në llogarinë e vet në "Facebook". Pas aksidentit, Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka shprehur keqardhje për këtë aksident dhe ka shprehur gatishmërinë t'i qëndrojë afër KFF Jakova dhe futbollisteve të këtij klubi për

ta kaluar sa më parë këtë traumë dhe lëndimet e pësuar nga ky aksident. Njëherësh, FFK-ja uron që futbollistet dhe i gjithë stafi i KFF Jakova të shërohen sa më shpejt nga lëndimet e pësuar dhe t'i rikthehen punës në fushën e gjelbër, duke shpresuar që raste të



tilla të mos ndodhin asnjëherë.

## Nora Gjakova fiton medaljen e artë në Baku, Distria Krasniqi të argjendtën

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 22 SHTATOR** - Sporti i xhudos edhe një herë e lartëson emrin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, pasi dy xhudistet Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi i kanë rrëmbyer dy medalje në "Grand Slam Baku 2023". Xhudistja Nora Gjakova e ka fituar medaljen e artë, pasi në finale e mposhti gjeorgjianen Eteri Liparteliani në 57 kilogramë. Xhiron e parë Gjakova e kishte të lirë, kurse në xhiron e dytë e mposhti garuesen nga Polonia, Arleta Podolak me Ippon. Në xhiron e tretë Nora gjermanen Seija Ballhaus, derisa në çerekfinale e mposhti me Ippon edhe francezen Priscilla Gneto.

Garuesja nga Peja në gjysmëfinale e mposhti me Ippon garuesen turke Hasret Bozkurt. Ky nuk ishte suksesi i vetëm i xhudos kosovare në Azerbajxhan, pasi medaljen e argjendtë e ka fituar xhudistja tjetër olimpikë Distria Krasniqi. Në finale, Distria ishte e pafat, duke u mposhtur në "golden spore" pas tri gabimeve nga japonezja Kisumi Omori. Në luftën e parë Krasniqi mposhti me "waza-ari" brazilianen Jessica Pereria, ndërsa në çerekfinale ajo triumfoi ndaj marokenes Soumiya Iraoui. Në gjysmëfinale pejania mori një fitore të madhe ndaj italianes Odette Giuffrida, kurse në finale pësoi humbje nga Omori. Sot (e shtunë) garojnë Laura Fazliu, Lorina Kuka dhe Akil Gjakova.



## Ejupi me emocione dhe krenari i jep fund një epoke dydekadëshe në FC Prishtina

"Epoka e re"

**PRISHTINË, 22 SHTATOR** - Remzi Ejupi, pas një epoke dydekadëshe në FC Prishtina, vendosi të largohet nga klubi kryeqytetas, duke i shitur të gjitha aksionet. Një ditë pas largimit nga klubi kryeqytetas, Ejupi në "Facebook" ka thënë se periudha 20-vjeçare ka qenë e suksesshme dhe me plot emocione. "Mes emocioneve dhe krenarisë për periudhën e suksesshme që e kisha te FC Prishtina, i kam dhënë fund angazhimit tim 20-vjeçar në klubin e kryeqytetit. Ishte emocionuese të lexoja dhe dëgjoja fjalë të mira të opinionit. Është e rëndësishme të



lësh përshtypje të mira dhe të dalësh me kokën lart pas çdo pune që bën. I falënderoj të gjithë për vlerësimin që ma kanë bërë. I falënderoj bashkëpunëtorët dhe

bashkudhëtarët e mi që i pata në krahë për këto dy dekada. Bashkërisht jemi munduar të bëjmë punë të mirë për klubin, për futbollin dhe për sportin kosovar

në përgjithësi", ka shkruar Ejupi, i cili më pas ka theksuar se nga viti 2004 është angazhuar me gjithë fuqinë e tij që ta ngrihet nivelin e futbollit në Kosovë deri në pranimin ndërkombëtar të tij. "Gjatë këtyre viteve kam takuar personalitete të ndryshme, përfshirë këtu edhe presidentët e FIFA-s dhe drejtues federatash, kam sjell klube të njohura evropiane dhe ish-futbollistë të njohur, por edhe yje shqiptare në stadiumet e Kosovës. Një prej punëve më të rëndësishme gjatë këtyre 20 viteve konsideroi se është angazhimi për ta jetësuar mbrojtjen e kartonëve të futbollistëve, të cilët më herët iknin drejt Evropës si "klandestinë", ka

shtuar Ejupi. "Jam i lumtur që kam sjell modelin gjerman të Ligjit për Sponsorizim, i cili u konsiderua dhe konsiderohet shpëtim për sportin. Falë këtij ligji u jepet mundësia bizneseve të lirohen deri në masën 30 për qind të tatimit në fitim me kusht që këtë vlerë ta investojnë në sport. Jam ndier tepër i nderuar që kohë më parë presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, më dekoroi me titullin 'Kalorës i urdhrat të flamurit', të cilin e vlerësoi një ndër vlerësimet më të larta për mua dhe familjen", ka shtuar Ejupi, i cili i ka falënderuar të gjithë bashkëpunëtorët. Në fund, Ejupi ka bërë një premtim: "Do të mbetem gjithmonë tifoz i zjarrtë i FC Prishtina".

## Daja: Kemi bërë një ndeshje të mirë karshi një kundërshtari të fortë

**SUHAREKË, 22 SHTATOR** - Skuadra e Ballkanit nga Suhareka nuk pati fat në ndeshjen ndaj Viktorias Plzenit, ku u mposht 1-0. Pas ndeshjes, trajneri Ilir Daja e cilësoi pozitive

ndeshjen për ekipin e tij. "Në fazën e mbrojtjes kemi bërë goxha mirë. Kemi pasur edhe ne situatat tona. Me një kundërshtar si Plzeni, në stadiumin e tij, kemi bërë një ndeshje të

mirë karshi një kundërshtari shumë të fortë. Goli u shënua me devijim dhe fati ishte me kundërshtarin. Kam çfarë t'ju tregoj çunave. Ka shumë gjëra pozitive kjo ndeshje. Nuk fshihemi në

fushë. E kontrollojmë topin më shumë se kundërshtari. Rastet që i kemi krijuar ishin me qarkullim të topit. Kemi bërë gjithçka mirë në këtë ndeshje të vështirë", ka thënë Daja.





## Rama: Talentet e sportit që jetojnë jashtë mund të marrin pasaportë shqiptare pa mbushur 18 vjeç

TIJANË, 22 SHTATOR - Talentet e sportit që kanë lindur dhe jetojnë jashtë Shqipërisë mund të pajisen me pasaportën shqiptare edhe kur nuk kanë mbushur 18 vjeç. Lajmin e ka

dhënë kryeministri i vendit, Edi Rama, i cili në "Facebook" ka shkruar se kjo ka ardhur pas ndryshimeve të miratuara në ligjin "Për shtetësinë" nga Kuvendi i Shqipërisë me

propozim të qeverisë shqiptare. "Tanimë me ndryshimet e miratuara në ligjin 'Për shtetësinë' nga Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të Qeverisë, u krijohet mundësia

talenteve të sportit që kanë lindur e jetojnë jashtë Shqipërisë, që të pajisen me pasaportën shqiptare edhe kur nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç", ka shkruar Rama.



## Nagelsmanni emërohet trajner i Gjermanisë

BERLIN, 22 SHTATOR - Julian Nagelsmann është trajneri i ri i Gjermanisë. 12 ditë pas lamtumirës së Hansi Flick, i shkarkuar pas disfatës së turpshme që skuadra japoneze i shkaktoi "Mannschaft" në Wolfsburg (1-4), Federata Gjermane e Futbollit (DFB) ka zyrtarizuar punësimin e trajnerit të ri, vetëm 36 vjeç. Nagelsmann do t'i udhëheqë pesë herë kampionët e botës të paktën deri në finale të "Euro 2024", të cilat do të mbahen në Gjermani midis 14 qershorit dhe 14 korrikut të vitit të ardhshëm. Me punësimin e tij, DFB synon ta rivitalizojë kombëtaren gjermane në kuota të ulëta që prej eliminimit qysh në fazën e grupeve të "Katar 2022". "Kemi nevojë për një frymë optimizmi dhe besimi përpara Evropianit që do të zhvillohet në vendin tonë", thuhet në njoftimin përmes të cilit u njoftua shkarkimi i Flick, i zgjedhuri për ta zëvendësuar legjendarin Joachim Low në detyrë pas fiaskos së Kupës së Botës 2018 në Rusi, në të cilën Gjermania ra në fazën e grupeve për herë të parë në



historinë e saj, dhe eliminimi nga Anglia në 1/8 finale të "Euro 2020". Me Flick në krye, gjermanët përsëritën fatkeqësinë e tyre në "Katar 2022", duke u eliminuar në rastin e parë. Tani, pasi është zgjidhur ndarja e tij nga Bayern Munich, vjen Nagelsmann, trajneri më i ri në historinë e Bundesligës. Në vitin 2015 ai drejtoi Hoffenheim në moshën 28 vjeç, gjashtë muaj dhe 18 ditë. Tri vjet më vonë Nagelsmann nënshkroi për RB Leipzig, të cilin e udhëhoqi drejt gjysmëfinaleve të

Ligës së Kampionëve 2019-2020 dhe finaleve të "DFK Pokal" më 2021, afër titullit të parë në historinë e klubit. Një periudhë e suksesshme që i hapi dyert e Bayern Munich, ku pasoi Flick. Në Bavari gjërat nuk ishin ashtu siç pritëshin. I nënshkruar me një libër çeqesh, pasi i pagoi Leipzig nga 25 deri në 30 milionë euro, Nagelsmann nuk i plotësoi dy nga pesë vitet që ra dakord me gjigantin gjerman. Ai u shkarkua në mars për shkak të mosmarrëveshjeve me bordin.

## Messi godet PSG-në: Jam i vetmi kampion bote që nuk mori mirënjohje nga klubi

Paris, 22 shtator - Aventura e Lionel Messit te PSG-ja filloi ashtu si duhet, por nuk përfundoi si histori e kampionëve, për faktin se parisienët nuk e trajtuan si të tillë kur u largua. Në një intervistë të dhënë, argjentinasit që aktualisht aktivizohet te Inter Miami, zbuloi se ai e kuptonte armiqtësinë e tifozëve në Paris pas fitores së trofeut nga Kombëtarja e tij në finalen e Kupës së Botës, e cila erdhi kundër vendit ku ai jetonte (Francës) dhe kontribuonte. Për ta theksuar këtë pikë edhe më tej, shtatë herë fituesi i "Topit të Artë" pretendon se ai ishte i vetmi lojtar i Argjentinës që nuk mori mirënjohje nga klubi pas triumfit në Kupën e Botës. "Edhe pse nuk është se pata një periudhë



shumë të bukur me Parisin, unë s'ërisht u shpalla kampion bote si pjesëtar i atij klubi. Unë isha i vetmi lojtar nga skuadra e Argjentinës që nuk mori asnjë lloj mirënjohje nga

klubi. Por, unë e kuptoj sepse në finale ishte Franca dhe prej fajit tanë ata nuk u konfirmuan si Kampionë të Botës", ka thënë Messi.

### SHKURT

#### KB Prishtina përforcohet me Tyron Harris

KB Sigal Prishtina ka njoftuar se është përforcuar me basketbollistin Tyron Harris. 31-vjeçari, që luan në pozitën e organizatorit, në Prishtinë vjen pas përvojës në Bosnjë-Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Turqi dhe Rusi. "Amerikani Ty Harris, 31-vjeçar, vjen në kryeqytet pas përvojës në shtete të ndryshme si Bosnjë, Maqedoni të Veriut, Turqi dhe Rusi. Harris në sezonin 2020/21 është shpallur MVP i sezonit në Ligën Ballkanike me skuadrën TFT, me mesatare 18.6 pikë, 7.5 asistime. Së fundmi Harris ka qenë pjesë e skuadrës Dynamo Vladivostok në Rusi", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

#### Pochettino: Broja mund të jetë kundër Aston Villas

Një lajm i mirë për Kombëtaren e Shqipërisë në prag të ndeshjes ndaj Çekisë, por më shumë për Armando Brojën. Sulmuesi kuqezi duket se tashmë ka lënë totalisht pas dëmtimin dhe rikuperimin e plotë fizik, pasi trajneri i Chelsea ka dhënë një deklaratë në konferencën për shtyp, duke theksuar se Broja është gati të luajë. "Broja mund të kthehet kundër Aston Villas, por vjen pas 9 muajsh jashtë fushave. Ne nuk mund të vendosim të gjithë përgjegjësinë te Broja për t'i shënuar të gjithë golat. Përgjegjësia duhet të jetë mbi ekipin dhe përpjekjen kolektive. Nuk mund të presim që Armando Broja të shënojë me çdo prekje të topit. Ai duhet ta ndiejë konkurrencën", është shprehur Pochettino.

#### Kapiteni Odegaard rinovon kontratën me Arsenalin

Martin Odegaard ka rinovuar kontratën me Arsenalin. Kapiteni i "Topçinjve" me kontratën e re do të jetë i lidhur me klubin deri më 30 qershor 2028. Odegaard është duke kaluar sezonin e katërt në "Emirates", duke përfshirë edhe të parin që ishte i huazuar nga Real Madridi. "Nënshkrimi i një kontrate të re ishte një vendim vërtet i lehtë për mua për shumë arsye. Kryesisht ajo që po bëjmë tani si klub është e veçantë dhe unë dua të jem pjesë e kësaj. Jam shumë i emocionuar për atë që do të vijë këtu. Kam gjetur një vend ku mund të vendosem vërtet dhe të thërras shtëpinë time. Historia ime është paksa e ndryshme ndoshta, pasi kam lëvizur nëpër klube të ndryshme që kur isha 16 vjeç. Në Arsenal, që nga dita e parë, jam ndier shkëlqyeshëm dhe kjo është padyshim shtëpia ime tani. Thjesht dua t'i falënderoj të gjithë ata që punojnë në klub dhe sigurisht, mbështetësit tanë fantastikë. Do të vazhdoj të jap gjithçka për t'i sjell sukses këtij klubi në vitet në vijim", ka thënë 24-vjeçari norvegjez.

#### Sancho nuk i kërkon falje Ten Hagit, largohet në janar

Manchester Unitedi është i gatshëm ta shesë Jadon Sancho në merkaton e janarit. Kjo do të thotë se është në listën e të padëshiruarve në "Old Trafford". Ish-lojtari i Borussia Dortmundit u pezullua pas një debati me Ten Hag, por mohoi të ishte stërvitur keq, siç kishte thënë trajneri i tij. Përplasja mes palëve vazhdon me refuzimin e anglezit për të kërkuar falje. Anëtori stërvitet vetëm në "Carrington" dhe duket se nuk ka të ardhme me "Djajtë e Kuq", nëse Ten Hag konfirmohet në bankinë. Lojtari kushtoi 73 milionë sterlina në vitin 2021 dhe për këtë arsye "Djajtë e Kuq" do të përpiqen ta shesin sa më shpejt që të jetë e mundur. Borussia Dortmundi tashmë është tërhequr nga gara dhe e ka bërë të qartë se nuk është e gatshme ta kthejë atë.

## Sainz: Fitoj sepse rrezikoj për të gjetur më shumë shpejtësi

Carlos Sainz dhe Ferrari ia dolën ta thyenin dominimin e Red Bullit dhe Max Verstappen në këtë sezon, teksa në Çmimin e Madh të Singaporit ishte pikërisht piloti spanjoll që kaloi i pari

vijën e finishit. Makina italiane dukej dukshëm e përmirësuar nga garat paraardhëse, ndërsa së fundmi Sainz shprehet se një nga faktorët që ndikuan në suksesin e Singaporit

ishte besimi i shtuar te njëvendëshja e tij. "Ferrari mbetet ende një makinë e komplikuar, ende po punojmë ta gjejmë mënyrën se si ta bëjmë që të funksionojë më mirë. E

vetmja gjë që mund të them është se po bëhet një punë shumë e madhe. Çdo fundjavë provoj diçka ndryshe për ta kuptuar më mirë makinën. Dua t'i besoj më shumë asaj dhe vetes.

Vetëm në këtë formë mund të mbërrijmë në një destinacion që nuk e kemi prekur më parë. Duhet të rrezikoj pak më shumë për të gjetur edhe më shumë shpejtësi", u shpreh Sainz.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSLOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 994/1  
Datë: 22.09.2023

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/I-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 20.09.2023 me nr. 303 së QK "Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë shpall:

## Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të QK "Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Agjencioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencioni duhet të ketë një dëshmi për marrëveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit ( KDSH ka përcaktuar datat nga 16, 17,18,19,20.10.2023-katër netë).
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menyë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2021-2022-2023)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuar!

### Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në eskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Durrës, Krujë, Berat, Vlorë etj.

### Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:


- Çmimi ofertues
- Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutjes do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyrë të AAAPARr në Prishtinë (Rruga "Agim Ramadani" p.n. ndërtesa MASHTI II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bahtir Murtezi nga Prishtina shpall të pavlefshme 3 dëftesat e shkollës së mesme Profesionale "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë.

- Albion Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.T "Nexhmedin Nixha".

- Leonis Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së -I- deri në të -VII- të shkollës fillore "Ali Mehasi".

- Zize Ahmeti nga Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 6-9 të shkollës fillore "8 Dëshmorët".

- Leutrim Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI – IX, SHFMU "17 Shkurti" "Atmaxhe.

- Hysen Shehu shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën " Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Fitim Gashi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Murat Pulaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat Q.K. "11 Marsi" Prizren

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



Sot bëhen 26 vjet pa më të dashurin, babanë, bashkëshortin dhe gjyshin tonë



## ISUF (NUHI) FAZLIU

Babë i paharruar, Ti ishe gëzimi dhe krenaria jonë. Gjysh shumë i mirë, por i pa shijuar. Urtësia dhe virtytet e tua do jenë gjithmonë udhë rrëfim për ne. E përkujtojnë: djali Saliu me familje, si dhe familja e gjerë Fazliu nga Celina, Prishtina, Zvicra dhe Gjermania.



